



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/180 Nr. i faq./Br.str./No.pg 73

Data/Datum/Date 26.12.2024

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 26.12.2024 miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-05537-2 në Zonën Kadastrale Rahovec

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/4797/24 i datës 07.10.2024 dhe merret vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës **P-71510057-05537-2** në Zonën Kadastrale Rahovec, në sipërfaqe prej 5.4m² (pesë pikë katër metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 300m² (treqind metra katror) në vendin e quajtur Przhina, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Temindar (Mehmedali) Shtavica.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë "Këmbimi i pronës private me pronën komunale për zgjerimin e rrugës Rahovec-Brestoc".
3. Parcela e cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2023-2031 me Nr.Prot.01 Nr.182/24 i datës 30.1.2024 ka destinim: 5. Banim/51.Banim me funksion të tjera të përputhshme.
4. Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmer të gjitha veprime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
5. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
7. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendim me 01Nr.259/24, i datës 29.10.2024.
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Kuvendit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËSNËRAHOVEÇ

01Nr.285/24
Datë:26.12.2024

